



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1244/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “DPTU Unija Pak Dooel”, me seli ne Shkup Republika e Maqedonisë se Veriut, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.C. nga Prishtina, kundër debitorit B.S. B.I me emër tregtar NPT “Rakita“ me seli ne Ferizaj rr. “Driton Islami” me numër unik identifikues 810638174, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, te paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore ne Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.168/20 dt.15.12.2020, me datën 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e debitorit B.S. B.I me emër tregtar NPT “Rakita“ me seli ne Ferizaj rr. “Driton Islami” me numër unik identifikues 810638174, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.168/20 dt.15.12.2020, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.168/20 dt.15.12.2020, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit B.S. B.I me emër tregtar NPT “Rakita“ me seli ne Ferizaj rr. “Driton Islami” me numër unik identifikues 810638174, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.65/2020 dt.10.03.2020 i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, ndërsa te njëjtin urdhër e ka lënë në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës kontestimore nenit 278 par.2, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe shkeljes e dispozitave te LPP, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë ne rivendosje.

Përgjigje ndaj ankesës se debitorit ka ushtruar kreditori, me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e debitorit si ne ankesë, propozon qe gjykata ta refuzoj ankesën e debitorit si te pabazuar dhe aktvendimin e atakuar ta vërtetoj, ndërsa kërkon shpenzimet e përpilimit te përgjigjes ne ankesën e debitorit.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “DPTU Unija Pak Dooel”, me seli ne Shkup Republika e Maqedonisë se Veriut, me datën 10.03.2020, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit B.S. B.I me emër tregtar NPT “Rakita“ me seli ne Ferizaj rr. “Driton Islami” me numër unik identifikues 810638174, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.32/18 dt.03.10.2018. Përmbaremore Privat Fadil Hoxha nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbaremore P.nr.65/2020 dt.10.03.2020, ka lejuar përmbaremoren, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t’ia paguaj borxhin ne shumen prej 8,523.40 euro, me kamatë prej 8% nga data 09.03.2020 e deri ne ditën e pagesës si edhe shpenzimet e përmbaremoren.

Kundër urdhrin përmbaremoren, debitori ka paraqitur prapësim me datë 15.04.2020, përmes se cilit deklaroi se e kontestoi shumen e kërkuar nga kreditori dhe se gjendja faktike është krejtësisht tjetër nga ajo sipas kreditorit. Borxhi ndaj kreditorit është shumë me i vogël ne krahasim me kërkesën e kreditorit dhe kërkon te behët ripërtëritja e procedurës ose te hudhet poshtë urdhri përmbaremoren.

Përgjigje ne prapësim ka bërë kreditori me datën 28.04.2020, përmes se cilës pretendon se janë te pabazuara arsyet e dhëna nga debitori ne prapësim, shton se me debitorin qe një kohë kanë marrëdhënie afariste eksport import te mallrave nga Maqedonia e Veriut ne Kosovë mirëpo pagesa e faturës nr.32/18 dt.03.10.2018 është paguar vetëm pjesërisht dhe se borxhi i debitorit është ne shumen prej 8,523.40 euro. Debitori asnjëherë nuk e ka kontestuar borxhin e lartcekur prandaj edhe kanë te lidhur një marrëveshje jashtëgjyqësore, arsyet e dhëna nga debitori kanë për qëllim vetëm përfitimin ne kohë dhe janë pa mbështetje ligjore, andaj, propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhri përmbaremoren te mbetet ne fuqi ndërsa i kërkon edhe shpenzimet e procedurës për përpilim te përgjigjes ne prapësim.

Gjykata Themelore ne Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerr aktvendim PPP.nr.168/2020 dt.15.12.2020, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbaremoren, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se debitori ka për obligim pagesën e shumes se borxhit prej 8, 523.40 euro ndaj kreditorit e kjo bazuar nga shkresat ne lende dhe marrëveshja për pagesën e borxhit e datës 11.02.2020. Pretendimet e debitorit se borxhi ndaj kreditorit është shume me i vogël i konsideron si te pabazuara sepse përfaqësuesi i kreditorit propozimit për përmbaremoren i ka

bashkangjitur faturën nr.32/18 dt.03.10.2018 dhe marrëveshjen për pagesën e borxhit ne këste te dt.11.02.2020 e cila është nënshkruar dhe vulosur nga ana e debitorit. Po ashtu edhe nga shkresa e datës 28.01.2020 konstatohet se kreditori përsëri ka kërkuar nga debitori qe brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimit te shkresës ta paguaj shumen prej 8,523.40 euro . Prandaj konsideron se ne pajtim me nenin 27 par.1 te LPP fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbartimi është e përshatshme për përmbartim, si edhe është plotësuar edhe kushti nga neni 3 i LPP. Bazuar nga këto arsye gjykata ka vendos si ne dispozitiv te këtij aktvendim.

Dhoma e Shkalles e Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 183 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të neni 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes. Në rastin konkret Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkalles se dytë.

Përkritazi kësaj çështje edhe gjykata e shkalles e dyte bazuar ne shkresat e lendes gjegjesisht ne dokumentin mbi bazën e te cilit është lejuar përmbartimi si edhe ne bazë te kërkesës se kreditorit dt. 28.01.2020 për pagesën e borxhit si edhe Marrëveshjes për pagesën e borxhit ne këste te datës 11.02.2020 gjënë se debitori është ne detyrim ndaj kreditorit për shumen e kërkuar sipas propozimit për përmbartim prej 8,523.40 euro. Fakti se debitori ka nënshkruar marrëveshjen për pagesën e borxhit ne këste te arritur me kreditorin gjykata e shkalles se dytë konsideron se i njëjti i ka pranuar detyrimet qe ka ndaj debitorit. Sa i përket transferit bankar qe ne shkresat e lendes është kopje dhe te cilit debitorit i referohet si pagesë e një shume te detyrimit qe ka ndaj kreditorit, kjo gjykatë vlerëson se nga ky transfer bankar nuk mund te kuptohet qartë se për cilën faturë ose detyrim bëhet fjalë pasi ne këtë transfer nuk është e precizuar fatura ose detyrimi për te cilin është bërë pagesa. Mbi bazën e këtyre rrethanave edhe kjo gjykatë vlerëson se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbartimi është dokument i përshatshëm për përmbartim sepse detyrimi nga kjo faturë është pranuar faktikisht me nënshkrimin e marrëveshjes për pagesën e detyrimit me këste ndaj kreditorit dhe se i njëjti si ne ankesën e tij e po ashtu edhe ne prapësim pohon faktin se ka paguar një pjesë te detyrimit te tij. Gjykata e shkallës se dytë analizozi edhe pretendimin ankimor te debitorit se shkresat e lëndës nuk me janë dorëzuar asnjëherë nga gjykata dhe se është dashur te thirret seancë ne këtë procedurë, ky pretendim nuk qëndron sepse debitori ka ushtruar te drejtën e tij sa i përket ushtrimit te prapësimi dhe pretendimeve te tij si dhe ka qenë ne dijeni për

detyrimin e tij ndaj kreditorit për çka edhe ka arritur marrëveshje me te njëjtin për pagesën detyrimit, gjë që i refuzoi si te pabazuara dhe paargumentuara dhe pa një ndikim për një vendosje ndryshe ndërsa aktvendimin e gjykatës e shkalles së parë e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1244/23, me datë 15.03.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova